

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Nr. Prot. / Prot. No. / Br. Stranica / No. Pages: 1299 / 8			
Klasif. Kod / Class. Code: 44			
Nr. Org. / Org. Unit: 03			



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTERIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. / Org. Jedinica / Org. Unit: 02	Nr. Prot. / Prot. No.: 25-3496
Nr./faqeve / Br. stranica / No. pages: 08	Data / Datum: 15.07.2022
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva- Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm – Ured Generalnog Sekretara –Office of the General Secretary

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATË/A:	12.07.2022
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Znj. Vlora Spanca, Auditor i Përgjithshëm
CC:	Znj. Kadrije Berisha-ZKF
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Dr. Rifat Latifi, Ministër i Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i veprimit të Auditimit për PV të MSh-së për vitin e përfunduar me 31.12.2021

I nderuar Znj. Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës

Bazuar në obligimet ligjore që kemi si Organizatë Buxhetore, keni të bashkangjitur gjeni të bashkangjitur Planin e veprimit të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të MSh-së për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2021.

Me respekt,

Ministria e Shëndetësisë Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i ZKA për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin e përfunduar 31.12.2021				
Raporti i Kapitujve	Institucionet përgjegjëse - Departamenti	Aktivitetet	Afati i Implementimit	Raporti i zbatimit
9 Rekomandime				
2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit				
Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve				
Rekomandimi A1 Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Një bashkëpunim më efektiv me Ministrinë e Financave do të lehtësonte gjetjen e zgjidhjeve, në mënyrë që të shmangen këto devijime.	Të gjitha programet ZKA ZKF Të gjitha Programet, Të gjithë ZKA dhe ZKF e	<ul style="list-style-type: none"> - Të gjithë hapat procedural në zbatim të vendimeve do të ndërmirren pas konfirmimit nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. - Njoftim për të gjeturën ndaj MFPT. - Do të bëhet shpenzimi dhe inicimi i procedurave sipas kategorive 	TM1 - TM4	

		programeve; Zyrtarët Zotues, Shpenzues dhe Certifikues	ekonomike		
Çështja A2 - Nënvlërim i obligimeve në PFV					
Rekomandimi A2		ZKF e programeve dhe mbajtesit e buxhetit	- Monitorimi në baza mujore për obligimet e paguara.	TM1 - TM4	
Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një kordinim më efektiv në mes drejtorive në raportimin e faturave të paguara me qëllim që në PFV të shpaloset vlera e saktë e obligimeve të paguara.					
Çështja B1 - Dobësi në regjistrin kontabël të pasurive					
Rekomandimi B1		Të gjitha programet	- Regjistrimi i rregullt vjetor i pasurisë; - Ministria do të regjistroj të gjitha pasuritë në Sistemin SIMFK dhe E-pasurisë në koordinim me MAP	TM1 - TM4	
Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MSH-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e					

<p>evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigojen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.</p>		<p>dhe MFPT;</p> <ul style="list-style-type: none"> - MSh në baza 3-mujore do të bëjë kontrollimin e regjistrimit të pasurisë bazuar në shpenzimet e realizuara. 		
<p>2.2.1 Pagat dhe mëditjet</p>				
<p>Çështja A3 - Kompensimi i pushimit të lehonisë në kundërshtim me ligjin e punës</p>				
<p>Rekomandimi A3</p> <p>Ministri duhet të ndërmerë të gjitha veprimet për të siguruar monitorim të vazhdueshëm të punonjësve/ specialistëve ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Në rastet e tejkalimeve duhet të aplikohet ndalesa në pagë për të korigjuar dhe evituar dëmtimin e buxhetit për vlerën e tejkaluar.</p>	<p>ZKA, Bordi Qendror specialistik Divizioni i personelit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Bordi qendror për shkollim specialistik do të obligohet që të njoftoj me kohë Divizionin e Burimeve Njerësore dhe DFSHP-në për të gjitha pushimet/prezencën në punë përmes 		

zyrtarëve përgjegjës.

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Çështja A4 - Mos respektimi i kërkesave të ligjit të TVSH-së

Rekomandimi A4

Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave se çdo faturë e pranuar dhe e paguar nga ana e Ministrisë duhet të jetë në përputhje me kërkesat e ligjit të ATK-së.
Po ashtu, Ministria duhet të rishikoj nëse normat e aplikuara të TVSH-së për këto fatura ishin adekuate dhe nëse ka devijime të ndërmerr veprime për korrigjimin e tyre.

Menaxheri i Kontratës

Njësia kërkuese

Divizioni i

- Janë ndërmarr veprime që faturat tani e tutje të jenë në formatin i cili ka të përfshirë edhe TVSh-në e ndar nga çmimi bazë.
- Do të kërkohet nga Kompania për konfirmimin e pagesave të TVSh-së.
- Obligohet njësia kërkuese që të verifikojë normat e TVSh-së para inicimit të procedurave.
- Divizioni i prokurimit obligohet të kërkoj

TM 1

TM 3

		prokurimit	sqarime për aktivitetet e inicuar nëse mungojnë specifikat teknike apo ka paqartësi-ndër to edhe për normat e TVSh-së.		
2.2.3 Investimet kapitale					
Çështja A5 - Vonesa në procesin e vlerësimit të tenderëve					
	Rekomandimi A5 Ministri duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave përfundohet brenda afateve të përcaktuara duke mundësuar që furnizimet të merren në kohën e paraparë. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse duhet të shqyrtohen zgjidhjet e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.	IKShPK	- Ministria e Shëndetësisë do të siguroj përmes monitorimit të rregullt që procedurat të përfundojnë brenda afateve të përcaktuara ligjore.	TM1 - TM2	
2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokatitale					
Çështja B2 - Mos harmonizimi në mes raporteve të inventarizimit dhe regjistrave të pasurisë					
	Rekomandimi B2 Ministri duhet të sigurojë se pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e	Të gjitha programet	- Ministria e Shëndetësisë do të themelojë komisionet sipas rregullores		

	pasurive.		financiare 02/2013.		
2.2.5 Të arkëtueshmet					
Çështja C1 - Mos arkëtimi i të hyrave në pajtim me Vendimin për gjobë nga Inspektorati Farmaceutik dhe Shëndetësor					
	Rekomandimi C1 Ministri duhet të sigurojë që marrëveshja e arritur fillon të zbatohet dhe në të gjitha rastet kur inkasimi nuk kryhet në kohën e duhur lëndët duhet të procedohen te përmbaruesi në mënyrë që të hyrat të inkasohen sa më parë.	Inspektorati Shëndetësor dhe Farmaceutik	<ul style="list-style-type: none"> - Gjatë procesit të auditimit të jashtëm është krijuar grupi për monitorimin e inkasimit të të hyrave; - Jemi më proces të dorëzimit të dosjes për procedim të përmbaruesi privat. - Obligohet Inspektorati Farmaceutik dhe Shëndetësor që si indikator kyc të ketë raportimin e lëndëve të dorëzuara për 	TM1-TM3	

			përmbarrim mujor.		
2.2.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm					
Çështja C2 - Mos mbajtja e takimeve nga komiteti i auditimit					
Rekomandimi C2 Ministri duhet të sigurojë se Komiteti i Auditimit mban takimet në mënyrë që puna e NjAB-së të monitorohet dhe të jetë e pavarur dhe efektive përmes zbatimit të rekomandimeve.	NJAB		<ul style="list-style-type: none"> - Dëshmit e mbajtjes së takimeve. - Është mbajtur një takim me Komitetin e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2022. 	TM1 - TM2	